

TAKIMI KOMBËTAR I SHOQËRISË CIVILE

Takimi Kombëtar i Shoqërisë civile dt. 24 Prill 2023

Piroritetet e dala nga grupet e punës që përfaqësojnë organizatat e shoqërise civile:

Në datën 24 Prill u mbajt, Takimi Kombëtar i Shoqërisë Civile

Ky dokument është një draft mbi gjetjet që grupet e punës dhe që lidhen në mënyrë të drejt për drejtë me rolin e KSHC-së për të mishëruar frymën e nxitjes së dialogut dhe të asaj që ligji parasheh në që Këshilli të këshilloj Këshillin e Ministrave për përcaktimin e politikave shtetërore për nxitjen e zhvillimit të qëndrueshëm të shoqërisë civile.

Ky dokument me prioritete dëshiron t'i hapë rrugën dhe të propozoj dhe të rekomandoj Këshillit të Ministrave në programet kryesore për nxitjen e zhvillimit të qëndrueshëm të shoqërisë civile dhe përfshirjen e këtij sektori në problematika që lidhen me kryerjen e reformave në fushën ekonomike, sociale, integrimin evropian, respektimin e lirive themelore dhe të drejtave të njeriut dhe forcimin e demokracisë dhe shtetit të së drejtës në vend.

Duke dhene gjithashtu rekomandime të vlefshme për politikat publike që lidhen apo ndikojnë në veprimtarinë dhe zhvillimin e organizatave të shoqërisë civile, si dhe përfshirjen e tyre në bashkëpunimin ndërsektorial.

Këshilli, është forumi më i lartë i transparencës dhe i llogari-dhënies në nivel kombëtar, dhe për rrjedhojë grupet e punës kanë pasur mundësi që në një dialog te hapur të shprehin edhe njëherë rëndësinë për ndryshime positive të cilat mund të kthehet në një instrument të vlefshëm.

Takimi kishte si objektiva:

- a) Të ofrojë mundësinë e dialogut dhe shkëmbimit të eksperiencave mbi veprimtarinë dhe sfidat e shoqërisë civile në vend përmes një procesi pjesëmarrjeje nga poshtë lart
- b) Të përfshijë, koordiniojë dhe unifikojë zërin e shoqërisë civile përmes takimit fizik dhe on line me anë të punës në grupe tematike.

Në takim organizata punuan në dy grupe pune mbi përparësitë e çështjeve të shoqërisë civile

Grupi I :

Demokratizimi, sundimi i ligjit, të drejtat e njeriut dhe integrimi në Bashkimin Evropian.

Grupi II:

a) Zhvillimi ekonomik territorialo-mjedisor

b) Përmirësimi i mirëqenies, shërbimeve sociale, mbrojtjes së shëndetit si dhe cilësisë së jetës

Shqetësimet kryesore që u ngriten në këtë takim në lidhje me rolin e KKSHC-së

- KKShC: Komunikuese; Informuese; Koordinuese; Mbështetëse
- Kush janë anëtarët e KKShC-së?
- Si dhe çfarë përfaqësojnë organizatat në Këshill
- Strategji nga anëtarët e KKSHC të mbështesin OSHCtë për të përcjellë shqetësimet / idetë etj pranë institucioneve
- OSHC duhet të informohen për platformën e KKSHC-së në faqen e AMSHC
- “Të kesh burime e të mos ekzistosh” – sepse ligji të penalizon
- Logjistika e takimit
- KKShC takime më të shpeshta koordinim + info + rrjetëzim midis KKSHC –shoqërisë civile + organizatave sipas fushave
- KKShC – Komunikim dhe konsultim me qeverisjen vendore
- Zv.Ministrja Agjencia e Pushtetit Vendor Mirëfunksionim i AMSHC-së; sekretariati
- KKShC “ , Fuqizimi i Llogaridhënies, Funksionimi, Mbështetja, Konsultimi

Të tjera:

Shqetësimet që organizata kanë në kuadër të vetë rregullimit dhe funksionimit të eksositemit të krijuar.

Organizatave që morrën pjesë në takim riafirmuan edhe njëherë shqetësimin se OJF-të e mëdha të vendosin një dysheme aplikimesh dhe për këtë kërkuan nga antarët e shoqërisë civile në KKSHC-së të marrin parasysh dhe të kenë një rol në lidhje me këtë shqetësim.

Prioritetet që pjesëmarrësit ndane në grupet e punës janë:

1. Vëmendje e shtuar dhe konsideratë për rek. E OJF-ve, Legj + politik
2. Taksimi / Qendrueshmëria Financiare
3. Mjedisi Mundësues
4. Legjitimiteti: Komunitetet e qytetatrëve
5. Shërbimet
6. Legjislacioni mbështetës
7. Qendrueshmëria Financiare:
 - Financimi me fonde shtetërore
 - Burokracia shtetërore (lera pa fund)
8. Institucione të hapura për OSHC-të
9. Mbështetje për organizatat e reja
Trajnime; mbështetje financiare
10. Mjedisi ligjor të jetë lehtësues dhe mbështetës:
 - Taksimi
 - Sponsorizimi
 - Gjobat
 - Mbështetja financiare
11. Taksimi”
 - Pronari përfitues

- Taksa bashkiake
 - Pagesa për sistemet online
12. Mjedis mundësues në aktivizëm:
- Akses në info
 - Akses në të dhëna
13. Vizibiliteti dhe imazhi I OSHC-ve
14. Zgjerimi i hapësirave për OSHC-të – ridimensionim i donatorëve
15. Mbështetje e shërbimeve të OJF-ve
16. Legjitimiteti : Pjesëmarrje aktive e grupeve të marginalizuara
- Ndërlidhja Kuvend – Qeveri – Pushtet Vendor
17. Ngritja në Këshill (në nivel qendror) e problematikave të pronësisë dhe përdorimit të kullotave dhe pyjeve nga komunitetet rurale

SFIDAT:

Mungesa e burimeve për mirëmbajtjen e softëare-ve dhe sistemeve regjistruese

OJF-të të trajtohen si biznes i madh, PSE?

Etiketohet OSHC-ja si jo miqësore dhe jo bashkëpunuese

Qendrat e shërbimeve të OJF-ve nuk janë future në skemën e dëmshpërblimeve nga dëmet e tërmetit.

Adresohemi shumë pak si grupe interesi për ligjet e reja

Nuk zbatohen ligjet – Niveli i shërbimeve është sh i ulët për personat me aftësi të kufizuara

Fashat e kostove administrative të projekteve shumë të ulëta për të siguruar burimet e zbatimit të projekteve

Rimbursimi i TVSH-së për fondet e BE-së: Cila është praktika? Standarti?

Qendrueshmëria financiare e OJF-ve

Diferencë/Disavantazh midis organizatave të vogla dhe të mëdha. Fondet copëzohen nga donator në donator

Agjendat e fondeve publike dhe të donatorëve nuk përputhen me aktivitetin / nevojat në terren

OJF-të nuk kanë qendrueshmëri tematike sepse jemi donor-driven = punojmë sporadikisht

Mekanizma koordinimi dhe komunikimi Brenda sektorit të OJF-ve qe tq gjitha nivelet të përfaqësihen grassroot – ojf të mëdha

Ligji për njoftimin dhe konsultimin nuk merr në konsideratë mendimet e OJF=ve

A na ka ndihmuar ligji për shoqërinë civile apo n aka penguar ekzistencën tonë si OJF? A ka hapësirë për përmirësim të ligjit?

OFT-të e mëdha të vendosin një dysheme për fondet që aplikojnë që të mos konkurojnë padrejtësisht me org. e vogla

OJF-të ndërkombëtare të mos jenë konkurrencte për OJF-të vendase për fondet për Shqipërinë

Ligji për regjistrimin e OJFve jo I zbatueshëm, kohëzgjatja e alogjikshme, edhe për modifikime ka probeme me bankën

Ministritë të kenë përfaqësuesin pikën e kontaktit për OJF-të

Shtimi I llogaridhënies dhe transparencës për fondet publike

Fodet publike janë të pamenaxhueshme se janë burokratike

Duhet folloë-up për diskutimet

Fondet e AMSHC-së më gjithëpërfshirëse dhe transparente për prioritetet e thirrjes

Organizatat e shërbimeve trajtohen si biznes dhe në procedurë prokurimi

Pushteti vendor duhet të sigurojë një mjedis pune për OJF-të locale (financim për infrastrukturë)

Kujdestaria për aftësinë e kufizuar duhet të njihet si vite pune

Për t'u trajtuar në mbledhjen më të afërme të Këshillit:

- ✚ Shoqata Aksion plus ne adrese te KKSHC-së ka parashtruar në takim por gjithashtu edhe me anë të një kërkesë zyrtare drejtuar me postë elektronike një propozim i cili ka të bëjë me financimin me bazë vjetore të një përqindjeje të caktuar nga të ardhurat e konfiskuara, për të mbështetur qendra trajtimi, që japin shërbime apo trajtojnë viktimat e këtij trafikimi si përdoruesit e substancave narkotike, të afërmit dhe familjet e tyre.

Arsyetimi

Shoqata Aksion Plus, duke vlerësuar rëndësinë e abuzimit me drogat si prioritet individual, familjar, social dhe qeveritar identifikon nevojën e ngutshme të ndërhyrjes me efektivitet në trajtimin e kësaj problematike. Duke vlerësuar paqëndrueshmërinë e financimeve nga donatorët që rrezikon trajtimin që marrin pacientët në qendrat e trajtimeve, e cila është jetike për ta, dhe shmang pasojat negative për komunitetin në tërësi, propozon që edhe në vendin tonë të ndiqet e njëjta praktikë me financimin e vazhdueshëm të qendrave trajtuese – para që vijnë nga konfiskimi i pasurive të përfituara nga trafiku i paligjshëm i lëndëve narkotike.

Shoqata Aksion Plus ju parashtron këtë kërkesë për të përmirësuar/ndryshuar ligjin, për shpërndarjen e parave që kapen nga konfiskimi i pasurive të paligjshme të përfituara nga trafiku i lëndëve narkotike.

Kërkesa dhe projekt-propozimi ynë mbështetet në ligjin “Antimafie”, që u sekuestron pasurinë shtetasve që dyshohet se merren me krim të organizuar dhe pastrim parash. Ligji në fjalë është botuar në Fletoren Zyrtare me numër 181. Kuvendi i Republikës së Shqipërisë e ka miratuar ligjin nr. 10192 datë 03.12.2009.

Në thelb, propozimi ka të bëjë me financimin me bazë vjetore të një përqindjeje të caktuar nga të ardhurat e konfiskuara, për të mbështetur qendra trajtimi, që japin shërbime apo trajtojnë viktimat e këtij trafikimi si përdoruesit e substancave narkotike, të afërmit dhe familjet e tyre. Deri tani AAPSK ka hapur thirrje për projekte të financuar nga ky fond, por thirrjet janë të kufizuara në kohë dhe frekuencë, ndërkohë që qendrat tona ofrojnë shërbime përditë.

Në kuadër të përafrimit dhe përmirësimit të legjislacionit në këtë fushë me partneret europianë, kjo shoqatë parashtron një propozim lidhur me çështjen e konfiskimit të aseteve kriminale nga shteti, dhe përdorimin e tyre për qëllime sociale, sipas praktikës së ndjekur nga shtetet anëtare të Bashkimit Europian. Financimi i qendrave të trajtimit të personave të varur nga droga duhet të jetë i vazhdueshëm, sepse dhe shërbimet e ofruara janë të përditshme, pa asnjë ndërprerje.